



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 1495/2022

Datë: 2 dhjetor 2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Shfuqizohen pikat II, III, V dhe VI të vendimit KPK/Nr. 1458/2022 i datës 23 nëntor 2022.
- II. Mbetet në fuqi pika I e vendimit KPK/Nr. 1458/2022 i datës 23 nëntor 2022, me të cilin Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe kryeprokurorët e prokurorive të Republikës së Kosovës kërkojnë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që menjëherë të anulojë vendimin Nr.03/109 të datës 23 nëntor 2022.
- III. Nga data 5 dhjetor 2022 të gjitha prokuroritë e Republikës së Kosovës do të rifillojnë punën me kapacitete të plota.
- IV. Pezullimi i bashkëpunimit për iniciativat e përbashkëta në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës do të vazhdojë deri në një vendim tjetër, ndërsa KPK dhe prokuroritë do të marrin pjesë në komisionet dhe grupet tjera ku pjesëmarrja përcaktohet me legjislacionin në fuqi.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Jetish Maloku


Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Kryeprokurorëve të prokurorive;
- Sekretariatit të KPK-së;
- Arkivit të KPK-së.